



ZYRA E KRYETARIT TË KOMUNËS

01- Nr- 016 - Goll

Më datë 22.01.2024

Duke u bazuar në nenin 13, dhe 58, të Ligjit Nr-03/L-040, për Vetëqeverisje Lokale, “Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr-28/2008”, e në mbështetje të nenit 25 të Ligjit Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/2022”, udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit, të përcaktuara me Metodologjinë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Kryetari i Komunës nxjerr këtë:

V E N D I M

1. Miratohet Plani Integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2024-2026 i hartuar nga Grupi Punues i caktuar nga Kryetari i Komunës sipas Vendimit 01-Nr-410-77357, i datës 12.12.2023.
2. z. Shaban ASLLANAJ-Zyrtar për Integritime Evropiane në Komunën e Suharekës, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit.
3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetari i Komunës.

Arsyetim

Ky vendim nxirret me qëllim të përmbushjes së obligimeve ligjore të përcaktuara me Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/2022), në raport me detyrimet e administratës qendrore dhe agjencitë e pavarura, si dhe autoritetet komunale për miratimin e Planeve të Integritetit.

Pas hartimit të planit të integritetit nga Grupi Punues i caktuar nga Kryetari i Komunës sipas Vendimit 01-Nr-410-77357, i datës 12.12.2023, i cili ka vepruar sipas udhëzimeve për përpilimin dhe zbatimin e planeve të integritetit dhe Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit, Kryetari i Komunës vendosi që ta miraton Planin e Integritetit për Komunën e Suharekës për periudhën 2024-2026, pasi që i njëjtë i plotëson të gjitha kushtet, kriteret dhe standardet e parapara në Ligjin Nr. 08/L-017 për Agjencinë për Parandalimin e Korrupsionit “Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 19/2022” dhe sipas udhëzimeve të parapara në Metodologjisë për Planet e Integritetit, të miratuar nga Agjencia për Parandalimin e Korrupsionit.

z. Shaban ASLLANAJ-Zyrtar për Integritime Evropiane në Komunën e Suharekës, caktohet person përgjegjës për monitorimin e zbatimit të Planit të Integritetit, i cili ka për obligim të monitoron procesin sipas planit të integritetit, zbatimin e masave të përmirësimit nga institucioni, përgatit treguesit për vlerësimin e efikasitetit dhe vlerësimin e rezultateve të masave të propozuara për përmirësimin e integritetit.

Nga ato që u tha më lartë, u vendos si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Kryetari i Komunës

Bali MUHARREMAJ

Të njoftohen:

- Anëtarëve të Grupit Punues;
- Personi përgjegjës;
- Agjencisë për Parandalimin e Korrupsionit.

